



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2021:260585

Datë: 13.03.2025

Numri i dokumentit: 06988587

NË EMËR TË POPULLIT

P.nr.129/2023

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - DEGA NË VUSHTRRI - Departamenti i përgjithshëm-Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Naim Rekaliu, me zyrtaren ligjore Artë Jusufi, në çështjen penale kundër të pandehurit F.K nga fshati ..., Komuna Vushtrri, për shkak të veprës penale Mbjajta në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK-së, i ngarkuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamentit të Përgjithshëm PP.I.nr.296/2021 të datës 07.04.2023, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar publik të mbajtur me datë 13.03.2025, në të cilin ishin të pranishëm prokurori i shtetit, i pandehuri dhe mbrojtësi i tij, në të njëjtën datë shpalli dhe përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I PANDEHURI: F.K, nga i ati Z..., e ëma Xh..., mbiemri i vajzërisë M..., i lindur me datën ..., në fshatin ..., komuna Vushtrri, ku edhe jeton, i martuar, baba i dy fëmijëve, pensioner, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

SHPALLET FAJTOR

I. SEPSE: Nga data e pavërtetuar e deri me datën 19.04.2021, rreth orës 00:15, ne lokalin “...” ne fshatin ... komuna e Vushtrrisë, mban ne posedim arme ne kundërshtim me ligjin mbi armët Ligji Nr. 05/L -022 Për Armë, ashtu qe gjate një kontrollë policia tek i pandehuri F.K i cili ishte rojë ne lokalin e lartcekur ne brez i kane gjetur një arme te tipit pistolete TT, me numër serik 210469, një karikator dy fishek te kalibrit 7.62mm, te cilat i kane konfiskuar Policia e Kosovës,

Me këtë ka kryer veprën penale: *Mbajtja ne pronësi, kontroll dhe posedim i paautorizuar i armeve nga neni 366 paragrafi 1 të KPRK-së,*

Andaj, gjykata konform dispozitave të neneve 4, 7, 17, 21, 38, 46, 47, 48, 49, 69 dhe 70 të KPRK-së, si dhe nenit 241, 242, 269, 276 dhe 364 të KPPK-së, të akuzuarin,

E G J Y K O N

I. ME DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen vepër tjetër penale në periudhën verifikuese prej një (1) viti.

II. Konfiskohet arma e tipit pistolete TT, me numër serik 210469, një karikator dy fishek te kalibrit 7.62mm.

III. DETYROHET i pandehuri që në emër të kompensimit të viktimave të krimit të paguajë shumën prej njëzetë euro (20€), si dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej tridhjetë euro (30€), të gjitha këto në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Pjesa hyrëse e aktgjykimit të arsyetuar.

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzën PP.I.nr.296/2021 të datës 07.04.2023, kundër të pandehurit F.K nga fshati ..., Komuna Vushtrri, për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 13.03.2025, në të cilën seancë ka prezantuar Prokurorja e Shtetit Rilinda Kadriu, i pandehuri F.K së bashku me mbrojtësin e tij sipas autorizimit, av.Kada Bunjaku-Përçuku.

Pas leximit të aktakuzës, nga ana e Prokurores së Shtetit, dhe pasi që gjykata është bindur se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet, si dhe sqarimit të

benefiteve dhe pasojave të pranimit të fajësisë, të njëjtit i është ofruar mundësia që të deklarohet lidhur me fajësinë. I pandehuri është deklaruar fajtor për veprën penale që i vihet në barrë, është penduar për veprën, dhe i ka premtuar gjykatës së më në të ardhmen nuk do të bie ndesh me ligjin.

Prokurorja e shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë dhe meqë i pandehuri kupton natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajësisë është vullnetar në konsultim me mbrojtësin e tij, po ashtu i bazuar në faktet e çështjes që përmban aktakuza, andaj i ka propozuar gjykatës që të njëjtin ta shpallë fajtorë dhe ta dënojë sipas ligjit dhe me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit të merr parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese, me të cilat do të arrihet qëllimi i dënimit.

Avokati mbrojtës lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar e pranon pranimin e fajësisë nga i mbrojturi i tij pasi që ky konsultim është bërë pas konsultimit me të pandehurin, se pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare dhe i vetëdijshëm për pasojat dhe natyrën e pranimit të fajësisë, ashtu që i ka propozuar gjykatës që ta miratojë pranimin e fajësisë nga ana e të mbrojturit të tij.

Gjykata duke vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka gjetur se, pranimi i fajësisë ishte në pajtim me nenin 242 par. 2 të KPPK-së pasi që, i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i pandehuri, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, se aktakuza nuk përmban ndonjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Faktet e çështjes në raport me provat që përmban aktakuza.

Gjykata ka konstatuar se pranimi i fajësisë është i mbështetur edhe në provat materiale të cilat mbështesin aktakuzën dhe atë: raporti policor nga zyrtari policor B.R dhe F.I, deklarata e të pandehurit, vërtetim për marrje të sendit, raporti i forenzikes, foto dokumentacioni si dhe shkresat tjera të lëndës.

Gjetjet e gjykatës lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit.

Gjykata kur vendosi të shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi u bazua në dispozitat 38, 46, 47, 48, 49, 69 dhe 70 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (06/L-074) dhe atë duke vlerësuar rrethanat lehtësues dhe rënduese të çështjes.

Për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor i pandehuri ligjvënësi ka paraparë mundësinë e shqiptimit të dënimit me gjobë deri në 7.500 euro ose me burgim prej deri në pesë (5) vjet, e në këtë rast gjykata ndaj të akuzuari vendosi që të shqiptoj dënim brenda kufijve të dënimit të paraparë me ligj, dhe atë dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen vepër tjetër penale në periudhën verifikuese prej 1 (një) viti.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së. Si rrethana rënduese për të pandehurin ka gjetur, shkallën e përgjegjësisë penale, ndërsa në kuadër të rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë, pendimin e tij për kryerjen e kësaj vepre penale, premtimin që i ka bërë gjykatës se nuk do të përsërisë vepra penale, më parë i pa gjykuar, ashtu që ndaj të njëjtit shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata erdhi në përfundim se lartësia e dënimit me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, dënim i cili nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në periudhën verifikuese prej 1 (një) viti, nuk kryen vepër tjetër penale, është dënim në përputhje me peshën e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale të tij, gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëj rehabilitimin e tij, por ai duhet të ndikoj edhe si preventivë e përgjithshme për personat tjerë që t'i parandaloj nga kryerja e këtyre veprave penale dhe të shpreh gjykim shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, të gjitha këto të parapara me nenin 38 të KPRK-së.

Vendimin për taksën e kompensimit të viktimave të krimit gjykata e ka marrë në bazë të nenit 6 paragrafi 1 pika 1.5 dhe nenin 39 par 3 pika 3.1 të Ligjit Nr. 05/L-36 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449 par 2 nën par 2.6 dhe nenit 450 par. 1 të KPPK-së.

Andaj, gjykata duke u bazuar në arsyet e lartshënuara ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal

P.nr.129/2023, datë 13.03.2025

Zyrtarja Ligjore

Arta Jusufi

Gj y q t a r i

Naim Rekalio

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Kosovë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimet të aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe për gjykatën.